

FORMULARI TIP I

Date: ___ / ___ / ___

NJOFTIMI PËR INFORMIM NGA KËRKUESI PRANË AGJENCISË KOMBËTARE TË MJEDISIT/AGJENCISË RAJONALE TË MJEDISIT DHE NJQV KU DO TË KETË VENDODHJEN INSTALIMI PËR APLIKIM PËR TU PAJISUR ME LEJE MJEDISI TË INSTALIMIT TË TIPIT A OSE B / NDRYSHIME NË FUNKSIONIMIN E INSTALIMIT TË TIPIT A DHE B

Bazuar në Ligjin Nr. 10 431, datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit", Ligjin Nr. 10 448, datë 14.7.2011 "Për Lejet e Mjedisit", Ligjin Nr. 60/2014, datë 19.6.2014 Për një ndryshim në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar dhe VKM 419, datë 25.6.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja", Kreu VI "Informimi dhe pjesëmarrja e publikut për aplikimin për leje mjedisi të tipit A dhe B", pika 2, Njoftimi duhet të përmbajë këto të dhëna:

1. Informacion nëse kërkesa do të jetë për "Aplikim për leje mjedisi të tipit A ose të tipit B" apo "Aplikim për ndryshim thelbësor në kushtet e lejes së mjedisit të tipit A ose të tipit B"; Aplikim për Leje Mjedisore Tipi B
2. Të dhënat e ekstraktit të QKR-së; "ALB-CANAJ" Shpk; MPTI: K07729901W
3. Adresën e vendodhjes së instalimit; Dibër, Bulqizë, Martonesh
Krastej Galeria nr. 1360, tek zona ere
4. Përshkrimin e veprimtarisë që parashikohet të zhvillohet në instalim; Minierë
në tokësore e shfrytëzimit të mineralit të Kromit
5. Një përshkrim të elementeve të listuara në formularin informues;
6. Përmbledhjen joteknike të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në nivel kombëtar ose ndërkuftar, kur kërkohet procedura e VNM-së në CD;
7. Konsultimet ndërkuftare, kur kërkohet sipas legjislacionit në fuqi; —
8. Autoritetin vendimmarrës për dhënien e aktit të miratimit të lejes së mjedisit, procedurat dhe afatet që do të ndiqen; Agjencia Kombëtare e Mjedisit
9. Adresën e AKM-së, ku publiku mund të dërgojë komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo në formë elektronike, brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e njoftimit;
info@akm.go.al

Mbaj përgjegjësi për dorëzimin e njoftimit pranë NJQV-së përkatëse në 20 CD/DVD

Kërkuesi/Përfaqësuesi i shoqërisë


Urim Canaj


Nr.kontakti

0697487976

PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE PËR AKTIVITETIN

“Minierë nëntokësore e shfrytëzimit të mineralit të kromit”



Subjekti: "ALB-CANAJ" SHPK

Vendndodhja: Diber, Bulqize, Martanesh, Kraste, Galeria nr.1360 tek zona e re

Tiranë, 2018

Permbajtja

1. Hyrje

1.1 Te pergjithshme

2. Pershkrimi i kuadrit ligjor dhe institucional

3. Pershkrim i mjedisit te rajonit

3.1 Te pergjithshme

3.2 Pershkrimi i territorit te projektit te propozuar

3.3 Shtrirja gjeografike

3.4 Relievi dhe tokat

3.5 Klima

3.6 Gjeologjia

3.7 Flora dhe fauna

4. Pershkrimi i aktivitetit

4.1 Veprimtaria dhe vendosja

4.2 Krahasimi tekniko-ekonomik dhe zgjedhja e variantit me te pershtatshem nepermjet te dhenave per secilin si sasia e punimeve, cmimi per njesi, vlera

4.3 Pershkrimi i kapacitetit prodhues

4.4 Percaktimi i jetes se minieres

5. Identifikimi i ndikimeve ne mjedis lidhur me aktivitetin

5.1 Shkarkime te ngurta

5.2 Ndikime nga shkarkimet e lengeta

5.3 Ndikimet ne ajer

5.4 Ndikimet nga zhurmat

5.5 Ndikimet ne popullsi

5.6 Ndikimet ne klime

5.7 Ndikimet e projektit ne rruget lokale dhe transport

5.8 Ndikimet ne ekonomi

1. HYRJE

1.1 Te pergjithshme

Subjekti "ALB-CANAJ" Shpk, eshte rregjistruar prane QKB-se me numer NIPTI : K07729901W. Vendi i ushtrimit te aktivitetit eshte ne: **Diber, Bulqize, Martanesh, Kraste, Galeria nr.1360 tek zona e re.** Objekti për të cilin kërkohet leja mjedisore është Shfrytezim kromi (minierë nentokesore).

Shfrytezimi i objekteve ne vendburim do te filloje me hapjen e shkalles nga lart-poshte duke pasur parasysh rregullat e shfrytezimit te trupave te Kromit. Fillimisht shfrytezimi do te filloje nga trupat ose blloqet qe jane gati te pregatitur per fillimin e shkalles se pare dhe ne vazhdim. Meqenese ne fillim te aktivitetit duhet te kryhen investimet e duhura per te siguruar frontet e prodhimit per vitet e metejshme, ne kemi planifikuar qe ne fillim te fillojme me kapacitete te vogla dhe ne vazhdim nga viti ne vit te vije duke u rritur.

Të gjitha punimet e përshkruara deri tani shërbejnë jo vetëm për lëvizjen e njerezve, transportin e mineralit apo sterility por dhe për ajrimin e minierës. Aktiviteti merr ne konsiderate masat e nevojshme per te siguruar qe menaxhimi i tyre te kryhet pa demtuar shendetin e njeriut dhe pa i sjell deme mjedisit vecanerisht:

- Pa krijuar rreziqe per ujin, ajrin, token, floren ose faunen
- Pa shkaktuar pengesa nga zhurmat
- Pa demtuar peisazhin

Nje synim tjeter eshte te percaktoje e rekomandoje masat teknike organizative per zbutjen e ndikimeve negative qe mund te krijohen gjate zhvillimit te aktivitetit. Në kete aktivitet te subjektit "ALB-CANAJ" Shpk, do te punohet njerez te profesioneve te ndryshme si: manovrator, inxhinier, germues etj. Për të krijuar një ambient pune optimal dhe mbrojtjen nga aksidentet, subjekti ka pajisur të gjithë punonjësit që punojnë në prodhim me uniforme, kapele mbrojtese dhe me mjete mbrojtëse.

2. PERSHKRIM I KUADRIT LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

Disa nga ligjet, aktet ligjore e nenligjore mbi të cilat mbështetet hartimi i këtij dokumenti, paraqiten si me poshte:

- Ligji Nr.10 431,date 09.06.2011 ' Per Mbrojtjen e Mjedisit '
- Ligji Nr16/2014 "Per mbrojtjen e cilesise se ajrit ne mjedis"
- Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 ' Per Lejet e Mjedisit'
- Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 'Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes'.
- Udhëzimin nr 8 dt. 27.11.2007 "Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara"
- Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 "Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta"
- Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve"
- Vendim nr.805 date 4.12.2003 'Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore'
- Udhëzim nr.1 date 03.03.2009 'Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis'
- VKM nr.419 date 25.6.2014 'Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mejdisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja.'
- Udhëzim per dokumentacionin e duhur per "Leje Mjedisore"
- Urdhëri Nr. 321 datë 11.2.2014 "Për Lejet Mjedisore"
- Udhëzim i MM dhe MF nr. 7938, datë 17.7.2014 "Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së"
- VKM nr. 686 datë 29.7.2015, "Për miratimin e rregullave të përgjegjësisive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore".
- Ligji 12.2015 date 26.02.2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 440 datë 7.7.2011Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis".


3. PERSHKRIM I MJEDISIT TE RAJONIT

3.1 Te pergjithshme

Objekti ku zhvillon aktivitetin subjekti " Alb –Canaj " shpk sh.p.k pozicionohet ne: Diber, Bulqize, Martanesh, Kraste, Galeria nr.1360 tek zona e re.

Koordinatat e pikave qe kufizojne zonen per shfrytezim jane si vijon:

Nr.pikes	Koordinatat e pikave		Z(m)
	Y	X	1360-1400
1	4435959	4591082	1239-1400
2	4436160	4590915	1237-1400
3	4436090	4508885	1360-1400
4	4435960	4591065	1336-1400
5	4435832	4591024	1360-1400
6	4435580	4591111	1360-1400
7	4435425	4591731	1360-1400
8	4435945	4591105	1360-1400
9	4436080	4591310	1360-1400
10	4435823	4591914	1360-1400
11	4436129	4592553	1360-1400
12	4436537	4592380	1360-1400
13	4436805	4591905	1360-1400
14	4436524	4591585	1360-1400
15	4437213	4590931	1360-1400



Pamje nga aktivitetit.



3.2 Pershkrimi i territorit te projektit te propozuar

Pozita gjeografike e Bulqizes, Diber ka luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e kësaj zone që ka qënë herë pozitiv e herë negativ në periudha të ndryshme historike dhe nën ndikimin e faktorëve socialë dhe ekonomikë që kanë lënë gjurmë në të. Rolin e saj pozitiv ajo e ka pasur kur ka shërbyer si një urë lidhëse për trevat e vendit tonë nga parendimi në brendësi të territoreve shqiptare. Që në antikitet ka funksionuar rruga Durrës - Fusha e Tiranës – Dibër, e cila lidhte bregdetin me vise të tjera lindore. Rolin e kësaj pozite e dëshmon qartë zhvillimi social-ekonomik, pasi në vitin 1911 Dibra ishte një qendër e rëndësishme artizanale, tregtare, ndërtimore etj. Për këtë flasin qartë të dhënat e popullsisë ku ky rreth kishte 11 000 banorë.

Por roli i kësaj pozite zbehet me vendosjen e kufijve arbitrare në 1913, ku jashtë mbeten qendra të mëdha tregtare (Dibra e Madhe) dhe urbane për kohën. Pas 1913 kjo zone vazhdoi ta luaj këtë rol por me një intensitet më të dobët. Deri kur në vitet 1945-1990 u ndërpre plotësisht kjo lidhje dhe u kthye në një faktor pengues dhe izolues për të. Pas viteve 1990 kjo zone e rimerr rolin e saj lidhës por me një intensitet më të vogël. Projekte të ndërtimit të autostradave që do të kalonte nëpër rrugën e vjetër dhe lidhja e saj me një arterje me rrethin e Kukësit do të rikthente një rëndësi të pozitive gjeografike të këtij rethi së bashku me burimet që përmban dhe do të kthente këtë rreth në një Qendër të një eurorajoni ndërkufitar duke bërë që pozita të bëhet faktor zhvillimi.

3.3 Shtrirja gjeografike

Rrethi i Dibres bën pjesë në rajonin verioro-lindor me një reliev përgjithësisht malorë kodrinor. Pra shtrihet në veri-lindje të Shqipërisë në dy anet e luginës së Drinit të Zi duke u kufizuar në lindje nga vargmali i Korabit dhe në perëndim nga vargmalet e Lures. Qendra e rrethit është qyteti i Peshkopisë që është edhe qyteti i 3-të pas atij të Shtetikut dhe Dibres së Madhe në republikën e Maqedonisë. Qendra e rrethit (Peshkopia) që shtrihet 185 km nga kryeqyteti dhe 21 km largësi nga pika e doganës së Bllatës në Maqedoninë e Veriut është vendosur në këto koordinata gjeografike: $41^{\circ} 53' 20''$, dhe $41^{\circ} 33' 40''$ gjatësi gjeografike veriore dhe $20^{\circ} 34' 50''$ dhe $20^{\circ} 07' 00''$ gjatësi gjeografike lindore. Kufizohet nga kufij konvencionalë në lindje me republikën e Kosovës dhe të Maqedonisë me një gjatësi kufitare 90 km nga të cilat 19 km janë lumore. Në veri kufizohet me rrethin e Kukësit me 75 km vijë kufitare. Në perëndim me Mirditën 13 km vijë kufitare dhe me rrethin e Matit me 60 km vijë kufitare. Në jug me Bulqizën 27,8 km vijë kufitare. Ky rreth ka një

ndertim te komplikuar gjeologjik qe eshte kapur here pas here nga levizjet neotektonike ngritese qe ka luajtur nje rol te rendesishem ne formimin e rrelievit.

3.4 Relievi dhe tokat

Rethi i Dibrës ka nje reliev kodrinor-malor qe varion nga 350 m (lug drinit te zi) deri ne 2751 ne majen e Korabit. Shtrirja nga 380m deri në lartësi të Korabit ka bërë që në të gjejmë shumë breza dhe nën breza tokash duke ndikuar drejtë për drejtë në bimësinë e zonës. Larmia e kushteve natyrore pedogjenetike ka kushtëzuar edhe shumëllojshmërinë e tokave. Në këtë drejtim dallohen:

- Tokat e kafenjta - kanë shtrirje jo të madhe dhe zënë 20 % të territorit të zonës shtrihen në lartësitë 600-1000 m mbi nivelin e detit, sidomos në pjesën veriore përgjatë luginave.
- Tokat e murrme pyjore - ose të pyjeve të ahut dhe të pishës që shtrihen në lartësitë 1000- 1200 m mbi nivelin e detit duke zënë pjesën më të madhe të kësaj malësie rreth 40%. Ato i gjejmë të përhapura në pjesën qendrore, jugore dhe atë lindore
- Tokat livadhore-malore - këto toka zënë 40 % të territorit të kësaj malësie dhe shtrihen në lartësitë mbi 1700 m mbi nivelin e detit. Ato i gjejmë të përhapura në lindje të zonës, dhe formohen mbi gëlqeror, në kushte të një klime të ashpër dhe me reshje, kurse relievi i tyre është heterogjen dhe dallohet për copëtim dhe pjerrësi të mëdha. Nga të dhënat rezulton se sipërfaqja e përdorur bujqësore përbën 12% të fondit total bujqësor. Pyjet dhe kullotat përbëjnë 77% dhe toka e papërdorur 11%

3.5 Klima

Rrethi i Dibrës bën pjesë në zonën klimatike mesdhetare malore dhe atë mesdhetare para-malore meqenëse është pjesë e pellgjeve të lumejve të Drinit. Në formim të kësaj klimë kanë ndikuar faktorë si lartësia dhe relievi e territorit, ndikimi i madh i klimës kontinentale nëpërmjet erave që vijnë nga grykat dhe qafat nga brendësia e Gadishullit Ballkanit. Si rezultat kjo klimë dallohet për klimë të ashpër, të gjatë dhe me reshje të mëdha të dëborës dhe verë të freskët por pa reshje . Temperatura mesatare vjetore arrin në 110 C. Janari është muaji më i ftohtë me një temp. mesatare minus 20C, ndërsa muaji më i nxehtë, gushti me një temp. rreth 210C. Temperaturat e ftohta arrijnë deri mbi minus 220.

Për sa i përket dukurive negative të klimës mund të themi se ajo ka karakter kapriçoz, pra ajo ka diktuar edhe vendosjen dhe mënyrën e ndërtimeve në këtë rreth. Po ashtu, kjo klimë është edhe shumë e shëndetshme, por nuk lejon kultivimin e të gjitha llojeve të bimëve si rezultat i ngricave të gjata dhe reshjeve të mëdha të borës, të cilët jo pak herë kanë shkatërruar prodhimet bujqësore dhe i ka dhënë drejtim të gabuar zhvillimit ekonomik. C. Rreshjet janë nën mesataren e vendit, ku mesatarisht bien rreth 912m/vit. Për reshjet e dëborës mund të themi se fillojnë mesatarisht me 1 nëntor dhe data e mbarimit është 20 mars. Shtresa maksimale shkon 1,5 m në shpatet e malit.

3.6 Gjeologjia

Rethi i Dibrës ka një ndërtim të larmishëm gjeologjik, i cili përbëhet nga molasat e plio-kuarternarit, flishiri dhe formacione të tjera magmatike dhe depozitime të kuarternarit. Vendin kryesor e zënë molasat e plio-kuarternarit, por gjejmë edhe rreshpet e paleozoit si dhe gëlqeroret e

mesozoit që janë edhe formacionet më të vjetra të vendit tonë, kurse shkëmbenjtë efuzivë dhe flishet ndërtojnë skajin më jugor të vargut të Korabit ku gjejmë edhe formacione karbonatike dhe ultra-bazike. Ndërtimi gjeologjik në këtë rreth mundëson zhvillimin, pasi kjo zonë është e pasur me minerale, lëndë ndërtimi dhe mermere. Këto formacione kanë bërë që ky rajon të ketë pasuri të shumta minerale ku veçojmë kromin në Selishtë e Lurë, bakrin në Cerjan e Lurë, mermerin në Muhurr, Arras, Rec, gipsin në përroin e Ilixhave, Bahutë Vrenjt, Kala e Dodës, hekurin në stanet e Preshit, Serokol, boksided në Lurë, bojra dheu në Bllicë, Sohodoll, Kabë, Erëbarë, squfurin në Kërcisht, dhe argjilat në Kastriot, Kubën dhe Dohoshisht. Pasuritë minerale që përmendën më sipër, përgjithësisht janë të pa shfrytëzuar, duke përjashtuar objektet e kromit që shfrytëzohen aktualisht dhe ato të mermerit e argjilës, të cilat sot nuk shfrytëzohen.

3.7 Flora dhe fauna

Pyjët zënë rreth 66% të sipërfaqes së përgjithëshme të qarkut, duke përbërë një potencial të rëndësishëm mjedisor dhe ekonomik. Në rrethin e Dibrës përfshihen tre zona fitoklimatike nga 4 që ka Shqipëria, dhe konkretisht: (i)- zonën e gështenjës (Castanetum); (ii) zonën e ahut (Fagetum); (iii) zona e hormoqit (Picetum); dhe (iv) zonën e kullotave alpine (Alpinetum) Në kuadrin e decentralizimit dhe rritjes së kompetencave të pushtetit vendor, rreth 60% e fondit pyjor ju janë dhënë në administrim njësisive të qeverisjes vendore.

Këto pyje përfshijnë teritore të cilat ato i kanë në administrim dhe që po mbështeten me investime nga projekti i pyjeve i Bankës Botërore, i cili ka si qëllim rimëkëmbjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të tyre. Relievi dhe klima e favorshme bëjnë që në këtë zonë të ndodhen të gjitha katet bimore të vendit tonë, duke filluar me shkurret mesdhetare deri në livadhet alpine. Në lartësinë deri në 800 m rriten disa lloje dushqesh si bunga, shparthi, qarri, etj., dhe mbi këtë lartësi takohet kryesisht ahu (*Fagus silvatica*), pisha e zezë (*Pinus nigra*), rrobulli (*Pinus heldreichi*), bredhi i bardhë (*Abies alba*), arneni (*Pinus peuce*), lajthia (*Corilus coturna*), mështekna (*Betula pendula*) etj, të cilat pas viteve 90, si rezultat i shfrytëzimit pa kriter kana pësuar dëme të shumta.

- Bimët mjekësore

Në rrethin e Dibrës vlerë të madhe për ekonominë e komunitetit kanë edhe shfrytëzimi i burimeve natyrore (bimëve mjekësore), të cilat kanë një përhapje të gjerë në shumë zona të këtij rajoni. Ndër këto bimë me vlera të mëdha mjekësore mund të përmendim: dëllinja e zezë (*Juniperus nigra*), dëllinja e kuqe (*Juniperus ohycedrus*), lulkuqja (*Papaver rhoeas*), sherebela, qershia e egër, trumza, trëndafili i egër (*Rosa kanina*), mullaga (*Malva sulvestris*), salepi (*Orchis mascula*), hithra (*Urtica dioica*), kamomili (*Chamomilla recutita*), blini, çaji i malit (*Sideritis roeseri*), murrizi (*Crataegus monogyna*), etj., të cilat mbledhen nga banorët e grumbullohen nga subjektet të licensuara të rrethit. Më pas dërgohen sipas destinacionit për eksport.

Theksojmë se ky potencial burimesh natyrore ndikon ndjeshëm në rritjen e të ardhurave e mirëqenies të banorëve në zonat rurale, si dhe kanë ndikim në uljen e varfërisë dhe papunësisë. faqe 14 nga 45 Në rrethin e Dibrës, duke qenë që kushtet e mjedisit si dhe pozicioni gjeografik janë të përshtatshëm për rritjen dhe zhvillimin e shumë llojeve me vlerë, duhet që të jetë në qendër të vëmendjes një përkujdesje ndaj rregullave dhe kriterëve të vjeljes e grumbullimit të këtyre pasurive natyrore, me qëllim menaxhimin e qëndrueshëm të tyre.

Fauna

Larmia dhe pasuria që ka kjo zonë si në aspektin klimatik, atë të tokave, të florës etj., ka krijuar kushte shumë të favorshme për zhvillimin e një bote shtazore shumë të larmishme. Këtë gjë e dëshmon ekzistenca e shumë llojeve të veçanta sipas karakterit të habitatit. Bota shtazore është shtrirë në gjithë teritorin si në atë të shkurreve, të pyjeve të dushkut, të ahut, e në lartësinë e kullotave alpine dhe të pak habitateve ujore. Në habitatet e dushkut, habitat ky që në 20 vitet e fundit vërehet një rimëkëmbje dhe rigjenerim i plotë i tij, në të gjitha vlerat e biodiversitetit, ka gjetur kushte zhvillimi dhe jetese shumë lloje të kafshëve të egra si: lepuri, thëllënxa e malit, derri i egër, ujku, dhelpra, etj.

Në habitatet e pyjeve të ahut dhe të pishës, që janë më të dëmtuara vitet e fundit dhe që vërehet një dëmtim i ekosistemeve dhe i faktorëve të biodiversitetit në tërësi, gjejmë një numër më të vogël të kafshëve të egra që jetojnë në këto zona si ariu, ujku, shqiponja, rrëqebulli, dhia e egër, kaprolli, etj. Në habitatet e ujrave të kthjellta dhe të ftohta të këtyre lumenjve takohet trofta e egër dhe disa lloje të tjera peshqish autokton që e bën këtë zonë të dallueshme nga zonat e tjera të vendit. E gjithë kjo, pasuri e botës shtazore dhe me vlera të veçanta ofron kushte për zhvillimin e turizmit malor, familjar, sportiv, ekologjik, çlodhës.

4. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

4.1 Veprimtaria dhe vendosja

Objekti ku zhvillon aktivitetin subjekti "ALB-CANAJ" shpk pozicionohet ne **Diber, Bulqize, Martanesh, Kraste, Galeria nr.1360 tek zona e re**. Miniera perbehet nga disa trupa minerali, te cilet do te shfrytezohen sipas cilesise, ne fillim do te shfrytezohen trupat me cilesi me te mire pastaj do te kalohet ne shfrytezimin e trupave me cilesi me te ulet qe do te kalojne ne pasurim. Punimet kryesore per hapjen e punimeve te parapergatitjes dhe shfrytezimit jane punimet, rruget kryesore te transportit qe kalojne ne formacionet shkembore ultrabazike, shkallet e karrieres, skarpata, kthesat ne sheshet e shkalleve si dhe sheshet e depozitimit si dhe punime te tjera ndihmese.

4.2 Krahasimi tekniko-ekonomik dhe zgjedhja e variantit me te pershtatshem nepermjet te dhenave per secilin si sasia e punimeve, cmimi per njesi, vlera

Trupi i mineralizuar ka vendosje pothuaj vertikale nga 60° deri ne 70° si ne shtrirje dhe ne renie. Per zbulimin e ketyre trupave te mineralizuar koeficientin e zbulimit do te marrim 15 m³ /ton. Lartesia e shkalleve te zbulimit jane parashikuar 10 ml. Ndertimi i shkalleve te zbulimit do te filloje nga siperposhte dhe gjeresia e sheshit ne shkalle do te jete 20 ml e cila ben te mundur levizjen e makinerive ne shkalle pa veshtiresi. Me uljen poshte te zbulimit gjeresia e shkalles se fundit do te arrije nga 30m-50m. Ne projektin teknik do te jepen relacionet, llogaritjet tekniko-ekonomike dhe i gjithë materiali grafik per kete qellim si dhe sasia e mineralit qe do te prodhohet.

4.3 Pershkrimi i kapacitetit prodhues

Duke u bazuar ne rezervat gjeologjike me siper pershkruam perafersisht rezevat te nxjerrshme ne total per te gjithë vendburimin pa i ndare sipas objekteve ne vecanti. Kapaciteti vjetor i minieres parashikohet te jete me mundesi rritjeje ne varesi te kerkesave te tregut dhe sasise se rezervave qe mund te zbulohen nga kryerja e punimeve te kerkimit ne nentoke. Per te siguruar kapacitetin e parashikuar, ne vendburim do te merren masa qe te sigurohet vazhdimesia e punes, sasia e prodhimit, cilesia si dhe elemente te tjere qe kane lidhje me vazhdimesine e punes ne kete objekt.

4.4 Percaktimi i jetes se minieres

Ne baze te kerkesave te tregut dhe kapacitetit te planifikuar per te prodhuar sasine e kerkuar dhe duke u bazuar ne sasite aktuale te rezervave te nxjerrshme, pa llogaritur rezervat qe do te shtohen nga punimet e kerkim zbulimit, jetegjatesia e vendburimit. Kurse objekti ne vecanti ka jetegjatesi te ndryshme ne varesi te sasise se rezervave qe do te zbulohen gjate viteve te punes.

Drejtimi i shfrytezimit

Shfrytezimi i trupave te mineralizuar do te behte nga lart-poshte. Drejtimi i avancimit te fronteve te prodhimit do te jete nga jug-perendimi ne drejtim te veri-lindjes dhe i blloqeve te shfrytezimit nga lart poshte. Vendosja e trupave dhe terreni krijojne mundesine e shfrytezimit ne disa shkalle, ne vartesi te prodhimit te kerkuar ne menyre te pavarur. Pra duke u bazuar ne radhen e shfrytezimit te objekteve te cilat jane ndare ne blloqe shfrytezimi, drejtimi i shfrytezimit do te jete i njejte nga lart-poshte duke patur parasysh dhe kuotat ne te cilen shtrihet trupi i mineralizuar.

Pershkrimi i punimeve kryesore te hapjes

Punimet kryesore te hapjes jane punimet qe kryhen ne hapjen e rrugeve deri ku do te filloje shkalla e pare e zbulimit si dhe vazhdimi i hapjes se shkalleve per te gjitha kuotat sipas projektit te pershkruar per kete qellim.

Shpim i lagur

Punimet e shpimit do te kryhen me cekic shpues me goditje e rrotullim me peshe relativisht te lehte qe shpojne ne thellesi deri ne 4 ml me diameter 38 deri ne 42 mm. Per te eliminuar pluhurin qe krijohet gjate punes i rekomandohet shoqerise vendosja e shpimit te lagur i cili i eleminon ata. Ky do te realizohet me vendosjen e bombulave te pergatitura me pare, te cilat jane te pajisura me dalje ajri dhe uji me saracineska 1/2 polic. Ajri i komprimuar futet ne bombul, i cili detyron ujin te dale nga bombula per tek cekici shpues. Bombula do te vendoset ne ane te galerise, ne nje vend te zgjeruar qe te mos ngushtoje seksionin e punimit dhe ne anen e tubacioneve te ajrit, te komprimohet. Tubacionet e ajrit dhe te ujit do te jene 1/2 polic. Fuqia punetore dhe specialistet do te sigurohen nga zona e Bulqizes mbasi ato jane me pervojte ne profesionet qe trajtuam me siper.

5.IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS LIDHUR ME AKTIVITETIN

5.1 Shkarkime te ngurta

Sterilet qe do te dalin nga procesi i shfrytezimi fillimisht depozitohen ne sheshe te vecanta provizore dhe mandej sapo te krijohet hapsira e nevojshme e shfrytezimit do te vendosen atje. E gjithë siperfaqja qe do te preket nga procesi do te rehabilitohet. Sasia e sterileve te zbulimit, perkohesisht do te depozitohet ne siperfaqet e parashikuara ne projekt dhe me vone do te ritransportohen dhe depozitohen ne sheshet e shkalleve dhe ne sheshin e poshtem. Ato perfaqesohen nga deluvione te shkriфта, qe nuk permbajne elemente ndotes per ambientin. Keto depozitime jane sterile dhe do te sherbejne me se miri per rigjenerimin e minieres. Gjate shfrytezimit te objektit nuk parashikohen depozitime llumrash.

5.2 Ndikime nga shkarkimet e lengeta

Nga miniera nuk ka dalje ujrash, ne procesin teknologjik te hapjes se punimeve minerare dhe nxjerrjes se mineralit te kromit perdoret uje i vendosur ne bombula per realizimin e shpimit te lagur dhe eliminimin e pluhurave nga proceset e punes. Ushtrimi i ketij aktiviteti, ne kushte optimale dhe perfundimi i veprimtarise ne objekt, nuk do te ndikojne ne nivelin e ujerave tokesore, ne rruget ujore dhe ne rrjedhen e ujerave nentokesore.

5.3 Ndikimet ne ajer

Ushtrimi i ketij aktiviteti nuk do te ndikojne ne cilesine e ajrit te zones mbasi gjate shfrytezimit nuk do te kete emetime te gazrave dhe pluhurave te cilet mund te shkaktojne ndotjen e ajrit, pervec produkteve te lendeve plasese per te cilat jane dhene shpjegime. Gjate fazes se zbatimit te projektit nuk do te kete emetime gazesh qe dalin nga mjete motorrike si produkte te djegies se karburanteve. Makinerite ne proces do te jene te certifikuara ne normat nderkombetare sic jepen ne projekt.

5.4 Ndikimet nga zhurmat

Zhurmat qe gjenerohen jane vetem ato te automjeteve qe vijne ne objekt per tu furnizuar me produktet, stoqet e sterileve te kromit. Keto zhurma nuk jane te niveleve te larta qe mund te behen shqetesuese per banoret, por brenda parametrave te lejuar sipas normave standarte mjedisore.

5.5 Ndikimet ne popullsi

Vendi ku do te zhvillohet aktiviteti eshte relativisht larg qendrave te banuara dhe nuk sjell shqetesime per ta vecse rrit mundesine e punesimit te tyre , duke rritur keshtu nivelin ekonomik te ketyre familjeve. Zhvillimi i ketij aktiviteti do te sjell te mira e sherbime jo vetem per investitorin por edhe per komunitetin. Ndikime ne shendetin e banoreve perreth nga zhvillimi i aktivitetit minerar ne kete objekt nuk parashikohet te kete.

5.6 Ndikimet ne klime

Gjate zhvillimit te projektit nuk priten ndryshime te dukshme klimaterike, si ne drejtim te permiresimit ashtu edhe ne ate te perkeqesimit te saj. Nuk do kete ndryshime ne temperature, ne drejtim te eres, ne sasine e reshjeve. Pra kryerja e ketij aktiviteti nuk ndikon fare ne kushtet klimaterike te kesaj zone.

5.7 Ndikimet e projektit ne rruget lokale dhe te transportit.

Subjekti do te perdore rruget ekzistuese. Gjatë zbatimit të aktivitetit nuk do kete ndryshime të rrjetit të rrugëve lokale dhe transportit. Për rrjedhojë aktiviteti nuk do ndikojë absolutisht në rrugët lokale dhe transport, përkundrazi subjekti është angazhuar të mirembajë rrugët lokale të transportit me qëllim të mbarvajtjes së mirë të aktivitetit të tij.

5.8 Ndikimet ne ekonomi

Persa i perket ndikimeve ekonomike ky aktivitet sjell ndikime pozitive ne ekonomi duke rritur te ardhurat jo vetem te investitorit por duke punesuar edhe punonjes nga zona perreth rrit nivelin e tyre te jetes.

Subjekti: " ALB-CANAJ " Shpk

Administrator: **Urim Canaj**

